



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.187, Datë 10.11.2017

**MBI
LIÇENSIMIN E SHOQËRISË ALBGAZ SH.A. NË AKTIVITETIN E SHPËRNDARJES
SË GAZIT NATYROR**

Në mbështetje të neneve 4, pika 50 dhe nenit 22, pika 2 gërma “b”; 24 pika 2 dhe nenit 50 të Ligjit Nr. 102/2015 “Për Sektorin Gazit Natyror” si dhe neneve 4, pika 1, gërma “b”; neneve 5; 11 dhe 12 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e liçensave në sektorin e Gazit Natyror”; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 10.11.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatoi se:

- Shoqëria ”Albgaz” sh.a. me shkresën Nr. 62 Prot, datë 19.07.2017 ka paraqitur pranë ERE aplikimin për tu pajisur me licencë në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 126, datë 16.08.2017, filloi procedurën për licensimin e shoqërisë Albgaz sh.a. në aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror.
- Bordi i ERE me vendimin nr. 179, datë 08.11.2017 miratoi Certifikimin e shoqërisë “Albgaz” sh.a në cilësinë e operatorit të kombinuar të gazit natyror.
- Me vendimin nr. 155, datë 28.09.2017, Bordi i ERE ka lënë në fuqi të vendimin e Bordit të ERE-s nr. 90, datë 07.06.2017 “Mbi miratimin e tarifës së përkohshme të transmetimit të gazit natyror nga shoqëria “Albgaz” sh.a. për periudhën 05.01.2017 – 20.09.2017” deri në 31.12.2017.
- Me vendimin nr.178, datë 08.11.2017, Bordi i ERE miratoi edhe “Metodologjinë e llogaritjes së tarifave të rrjetit të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit natyror.”

- Albgaz sh.a me shkresat nr. 521/4 Prot., i ERE datë 09.10.2017, nr. 139 Prot., i ERE datë 21.11.2017, dhe nr. 139/1 Prot datë 07.11.2017, ka përcjellë në ERE plotësim dokumentacioni për aplikimin e tij.
- Aplikimi i shoqërisë “Albgaz” sh.a, plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e gazit natyror” si më poshtë:
- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërmat “a”, “b”, “c”, “d” (pikat i,ii,iv); gërma “e” Dokumentacioni dhe garancitë financiare pikat i, ii, v, vii, është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9 pika 2, gërma “b”, pikat i, ii, iii, v, vi, vii, viii, ix, x, xi, xii, xiii, xiv, xvi.

Për dokumentacionin e munguar që ka të bëjë me:

- Formati dhe dokumentacioni për aplikim, neni 9, pika 1, gërma “d” (pikat v, vi,);
- Dokumentacioni dhe garancitë financiare, neni 9, pika 1, gërma “e” pikat iv, vi,
- Dokumente specifike për llojin e licencës, neni 9 pika 2, gërma “b”, pikat iv, xv, xvii, xviii, do të njoftohet subjekti që ti depozitojë ato brenda afatit të përcaktuar në kushtin e dispozitivit të vendimit.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

Vendosi:

1. Të licencojë shoqërinë “Albgaz” sh.a. në aktivitetin e Shpërndarjes së Gazit Natyror për një afat 30 – vjeçar, me kushtin që brenda afatit 6 mujor në mbështetje të nenit 24 pika 2 të Ligjit nr. 102/2015, “Për Sektorin e Gazit Natyror” të plotësojë të gjithë dokumentacionin e munguar si më poshtë:
 - Dokumentacioni që tregon titujt e pronësisë mbi asetet që ka, për të kryer funksionet ose plotësuar detyrimet nën licencën e kërkuar.
 - Lejet dhe autorizimet mjedisore
 - një certifikatë sigurimi nga shoqëri sigurimi (që operojnë në përputhje me legjislacionin në fuqi në Shqipëri) që evidenton mbulimin e përgjegjësisë për dëmtimet për plagosje, sëmundje ose raste të vdekjes së Personave ose për humbjen ose shkatërrimin e pronës të shkaktuara ose që kanë rezultuar prej aktiviteteve të Aplikantit në kuadër të Licensës së kërkuar në një nivel përgjegjësie jo më të vogël se 10 milion USD.
 - plan biznesi.
 - Volumet e projektuara ditore për t’u përpunuar sipas vlerësimeve të Aplikantit.
 - Programin e punës për zbatimin e projektit dhe jeta e pritshme e projektit.
 - Programi i parashikuar i mirëmbajtjes së Sistemit të Shpërndarjes.
 - Sasia mesatare e gazit natyror që parashikohet për t’u shpërndarë gjatë një viti mbështetur në një program tipik mujor.

2. Shoqëria e licencuar ka detyrimin të respektojë kushtet e parashikuara në licencën për aktivitetin e shpërndarjes së gazit natyror që miraton Bordi i ERE.
3. Drejtoria e e Licencimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë palët e interesuara për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Kryetari
Petrit AHMETI